



## PROCESVERBAL XI/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 26.11.2024  
**Ora :** 13:00

---

### **Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
*z. Urim Suka*  
*znj. Bulëza Kuçi*  
*znj. Sanie Kuçi Rexhepaj*  
*znj. Fidaije Kukaj*  
*z. Dardan Berisha*  
*z. Liridon Fandaj*

### **Të pranishëm tjerë:**

**Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka**  
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe zëvendës drejtor të IEAA-AP;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;**

**Kryesuesi** - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

**Urim Suka** - ne jemi duke e mbajtur KPF-në dhe materiali për Asamblenë na ka ardhur. Dua ta di arsye pse? Nëse ka arsye të bazuar sepse përndryshe nuk ka kuptim të mbajtur këtë takim sepse pikat kanë shkuar.

**Avni Bytyqi** - çështja e caktimit të takimit njëri pas tjetrit është për arsye se unë kam qenë jashtë shtetit por nuk ka ndonjë shkelje ligjore sepse asnjë dispozitë ligjore nuk e rregullon çështjen që së pari të caktohet KPF-ja dhe të kalon e pastaj Asambleja. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - pasi nuk ka vërejtje e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kërkon informacion shtesë.

**Armend Krasniqi** - përshëndet të pranishmit. Kemi inçiu një procedurë për dhënie në shfrytëzim të pronës i cili gjendet në anën e njëjtë me Hendikos dhe shkollën e mesme. Parcela është e planifikuar sipas HZK-së ndërtimi i lart ZSHP 5 dhe është parcelë që nuk i plotëson kushtet mbi 10 ari për me ndërtu vet komuna, andaj të gjitha parcelat që janë kështu, komuna duhet me iu bashkëngjitur blloqeve të ndërtimit të komunës së saj në mënyrë që të përfitoj banesa në këmbim të dhënies në shfrytëzim të kësaj prone.

**Urim Suka** - fillimisht e japim pëlqimin dhe në Asamble përgatitemi më mirë dhe e diskutojmë.

**Liridon Fandaj** - këtu një pjesë e parcelave është bërë një ndarje në shkurt 2023. Cila ka qenë arsya? Mos ka qenë arsya pikërisht për këtë që sot ne me ia përshtat dikujt dhe me ia dhënë 348m. A duhet pëlqim paraprak për këto ndarje dhe këto lëvizje në Asamble?

**Armend Krasniqi** - për pronën të cilën po flet, ka pas një miratim në vitin 2013 në Asamble ku edhe përkundër HZK-së ka pas vendim shtesë të Asamblesë dhe edhe vendimi dhe HZK-ja kanë bërë që me ekzekutu si ndarje në kataster. Është e vërtetë që në kuadër të kësaj është krijuar një parcelë ndërsa me

ndarjen e kaluar është bërë një rrugë që ka qenë zgjidhje e mirë për qytetin. Është bërë në bazë të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

**Liridon Fandaj** - kjo ndarje a ka vendim?

**Armend Krasniqi** - ka vendim të Asamblesë dhe e njëjta lëndë është duke u hetu në krimet ekonomike mirëpo po hetohet pa kurrfarë lidhje.

**Liridon Fandaj** - për deri sa ka një hetim për këtë lëndë dhe asnjëri vendim nuk është bshkangjit në lëndë atëherë kjo të lë me dyshu.

**Armend Krasniqi** - e kam studiu mirë HZK-në dhe aty ku janë parapa rrugë. Drejtorja e Urbanizmit dhe Drejtorja e Katastrës duhet me marrë iniciativë për hapjen e rrugës.

**Kryesuesi** - parcella në fjalë prej 348 m<sup>2</sup> e ka numrin e fletës poseduese ,ju e lakuat që hetohet nga krimet ekonomike, a ka të bëj diçka me këtë numër të parcelës?

**Armend Krasniqi** - nuk ka të bëj.

**Urim Suka** - nëse kjo që ne po flasim ka hetim prej krimeve ekonomike, a mundemi ne me ec tutje?

**Avni Bytyqi** - po sepse është kontest penal. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime. Unë vendimin nuk e kam pa por mos rastësisht kjo ndarje është bërë kur është bërë ndarja për parcelën e Hendikosit dhe kjo ka mbet si shtesë?

**Armend Krasniqi** - po, ajo ndarje është.

**Bulëza Kuçi** - nga disa vizita që kemi pas në Hendikos, ata kanë kërku dhe kanë pas nevojë për një parcelë tjetër. A do të ishte më mirë me ia siguri Hendikosit çështjen e magazinave që po i mungojnë?

**Armend Krasniqi** - aty ku është e paraparë me u ndërtu 5 kat, nuk ka shanca me ndërtu magazinë 1 kat.

**Urim Suka** - Hendikos ndoshta mund ta merr atë parcelë dhe e bën 5 kat.

**Avni Bytyqi** - duhet ta shohim interesin e komunës dhe interesi i komunës është me dhënë në shfrytëzim.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

## 6 për, 1 apstenim, Miratohet pika 2.

### Pika 3. Sqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - skica e fundit që na keni përcjell ku është tabela e këmbimit të pronave, po na dalin dy parcela me numër të njëjtë kadastral, që më duket që është gabim teknik dhe që duhet të rregullohet për Asamble. A po zgjidhet problematika me anë të këtij këmbimi sepse mua më duket që nuk po zgjidhet problematika dhe duhet edhe diçka tjetër me shtu për me zgjedh këtë problem që me pa mundësi të ndërtimit në këtë zonë.

**Armend Krasniqi** - për parcelën 112 besoj që është gabim teknik ndërsa kërkon edhe një herë përsëritjen e pyetjes së dytë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - hyn në gjiroportal dhe thotë që rruga e planifikuar nuk po shkon në vijë kadastrale por po shkon pak më posht dhe ky trekëndëshi që është kriju këtu është pronë publike dhe parashihet ndërtim i lartë. Pse mos me dhënë edhe këtë dhe me bo bllokun e pastër?

**Armend Krasniqi** - kërkon pak kohë deri të vijë zyrtari i pronës Atdhe Buzhala që të jep sqarime sa i përket pyetjes.

### Pika 4. Sqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe zëvendës drejtor të IEAA-AP;

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Bulëza Kuçi** - këtu po përmendet komision atëhok.

**Avni Bytyqi** - është vetëm për një konkurs.

**Bulëza Kuçi** - pse po arsyetohet këtu? A po mungon dikush prej komisionit?

**Avni Bytyqi** - Ministria e Arsimit e ka nxjerr një rregullore në vitin 2024 për procedurat e përzgjedhjes së mësimdhënësve, konkurset e zëvendës drejtorave, drejtorave dhe i ka parapa që për secilën procedurë të

konkursit ka për obligim me formu komision.Komisioi ka mandat atëhok deri në përfundimin e zgjidhjes së pozitive dhe vendimit përfundimtar.Të jem i sigurt edhe mua nuk më pëlqen kjo procedurë.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - për Arta Hoti përfaqësuese e këshillit të prindërve dhe profesoreshë,ne e kemi diskutu edhe më herët.Edhe drejtori nuk di të na kthej përgjigje.

**Avni Bytyqi** - ka mundësi e ka delegu këshilli i prindërve.Zyrtari ligjor jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - po i bie dy përfaqësues të DKA-së edhe pse ajo është delegu prej dikujt,ajo po punon aty.

**Bulëza Kuçi** - gjithashtu ne kur e kemi diskutu atëherë,nuk mund të vinim në përfundim se kush janë ata përfaqësues dhe kush e ka zgjedh atë sepse nuk kishte as procesverbal.

**Dardan Berisha** - pse nuk ka një procesverbal që e ka delegu atë?Ne nuk kemi një dokument që e kanë delegu.

**Urim Suka** - si procedurë vjen prej DKA-së.Në rastin konkret kur po flasim për më herët,atëherë na ka ardhë emri Arta Hoti dhe ka shkru përfaqësues i këshillit të prindërve.Ne atëherë për këtë propozim kemi këku procesverbal se a e ka sjell këshilli i prindërve por ka dal që s'e ka sjell këshilli i prindërve.Ne nuk kemi asgjë kundër me Artën por nëse e ka propozu këshilli i prindërve,me pas një procesverbal dhe nëse nuk e ka propozu është e drejtë e drejtorit të DKA-së me propozu sipas rregullores dhe ne jemi të interesuar me kalu si procedurë.

**Dardan Berisha** - proceduralisht nëse ka shku si e ka dërgu kërkesën,këtu Drejtori i DKA-së ka të drejtë me bë komision komplet vet dhe këtu nuk po thotë që Arta Hoti është përfaqësues i këshillit të prindërve por nuk po shkruan që e kanë delegu prindërit.

**Avni Bytyqi** - ekskluzivisht është kompetencë e drejtorit kënd e merr dhe a kanë një procedurë të brendshme këshilli i prindërve se kush me shku,ajo është temë tjetër.

**Liridon Fandaj** - ai ka të drejtë kënd të dojë me marrë por nuk duhet ti shkruaj përfaqësues i këshillit të prindërve.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

#### 4 për,2 apstenime,Miratohet pika 4

#### Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që sipas ligjit për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive të tjera,dëmet të cilat shkaktohen nga faktori njeri ose që nuk dihet faktori,nuk kompenzohen nga AME por AME kompenzon dëmet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore.Atëherë unë kam kontakt me AME dhe ata kanë thënë që nuk e kompenzojmë ne sepse nuk dihet nga kush ka ardhë.Pra këtu dëmet nuk kanë ardhë nga fatkeqësitë natyrore por nga faktori njeri.Jemi konsultu me Kryetarin dhe për Asamble vendimi është i formave sikurse kemi vazhdu me ato dy familjet e mëhershme,me nga 5 mijë euro nga kategoria e subvencioneve të zyrës së Kryetarit.

**Liridon Fandaj** - jam interesu për rastin e parë në Nishor dhe kam pyet në AME dhe ata kanë thënë që kjo nuk hyn në fond sepse e kemi vetëm për fatkeqësi natyrore.Është mirë edhe zyrtarit që po i bën raportet me ia sqaru,që mos m'i thënë qytetarëve që po i ndihmon AME.

**Dardan Berisha** - ju e keni kuptu që AME nuk ka të drejtë me pagu para se me dërgu ju materialin? sepse këtu edhe neni 2 dhe neni 3 thotë që mjetet lëshohen nga AME.

**Avni Bytyqi** - siq e ceka për Asamble vje vendim tjetër,i ndryshuar.

**Urim Suka** - unë nuk e di a ekziston një komision në kuadër të komunës për vlerësimin e dëmeve të kësaj natyre.Nëse ekziston një komision,është mirë mirë në raste të tilla komisioni me bë vlerësimin e dëmeve dhe ne me marrë një vendim ku me përqindje e bëjmë kompensimin sepse nese dikujt iu ka kall kati i parë dhe ia japim 5 mijë euro dhe dikujt iu ka kall komplet shtëpia dhe ia japim 5 mijë euro,nuk është vlerë e barabartë.Ne sot po e miratojmë por për të ardhmen është mirë me mendu që ne me qenë më të barabartë.

**Kryesuesi** - është një inspektor për parandalimin e zjarreve, i cili del dhe i konstaton dëmet e zjarrit. E hedh në votim pikën 5.

### **Unanimisht Miratohet pika 5**

#### **Pika 3.**

**Kryesuesi** - pasi zyrtari i katastrës është i pranishëm, ia jap fjalën Sanie Kuçi Rexhepaj.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - ndoshta je në ngjarje që na ka ardhë një kërkesë për shpallje të interesit të përgjithshëm. Në momentin që po këmbehen këto dy parcella, po krijohet një trekëndësh dhe prap po mbet e komunës sepse është pjesë e parcelës 2760-0.

**Atdhe Buzhala** - është pasuri shoqërore rrugë dhe rruga në këtë rast është rrugë magjistrale dhe nuk kemi mujt me bë kompensim. Për pjesën tjetër investitori e ka mendu që me hy procedurë tjetër, bonus ndërtim.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - në momentin që e merr Urbanizmi me realizu këtë bllok ndërtimor dhe këtu po hyn edhe pasuria shoqërore rrugë dhe unë po mendoj që ka me pas drejtoria pengesa për me lëshu leje ndërtimore për shkak se brenda bllokut është edhe një pronar tjetër. Nuk jam kundër por ne jemi duke e bë këmbimin për me zgjidh problemin e lejes.

**Atdhe Buzhala** - propozimin e ka bë Drejtori i Urbanizmit.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - atëherë sqarimet duhet të na jap Drejtori i Urbanizmit.

**Kryesuesi** - në Asamble kërkoni sqarime nga Drejtori i Urbanizmit. E hedh në votim pikën 3.

### **3 për, 4 abstenime, Miratohet pika 3**

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj